

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Avdi Dinaj dhe Valdete Daka anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit R. B., nga Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 2 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit R. B., G. B. av. nga Peja, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për krime të rënda Pejë, P.nr.10/2012 datë 29.5.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamenti për krime të rënda Prishtinë, PAKR,nr.392/2015 datë 17.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 shkurt 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit R. B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për krime të rënda Pejë, P.nr.10/2012 datë 29.5.2015 dhe atij të Gjykatës së Apelit-Departamenti për krime të rënda Prishtinë, PAKR,nr.392/2015 datë 17.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për krime të rënda Pejë, P.nr.10/2012 datë 29.5.2015, i dënuari R. B. është shpallur fajtor për një veprë penale në vazhdim marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK dhe për këtë veprë penale është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh dhe dënimin plotësues ndalimi i

ushtrimit të profesionit si pylltar në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. E ka detyruar që në emër të shumë paushalle të paguajë shumën prej 25 €. Të dëmtuarin R. S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim, konform dispozitës së nenit 364 par. 1 pika 3 të KPPK-së është liruar nga akuza, për veprat penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 të KPK dhe lajmërimi i rrejshëm nga neni 306 par. 1 të KPK. Për këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit – Departamenti për krime të rënda në Prishtinë, PAKR.nr.392/2015 datë 17.11.2015 në mënyrën sa vijon:

“I Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit R. B., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.10/2012 datë 29.5.2012 ndryshohet përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale ashtu që Gjykata e Apelit gjen se në veprimet e të akuzuarit të përshkruara nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 2 të KPK.

II Ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit në baza tjera ankimore refuzohen si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar në pjesën tjetër, vërtetohet.”

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për krime të rënda, P.nr.10/2012 datë 29.5.2015 dhe atij të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.392/2015 datë 17.11.2015, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit R. B., G. M., për shkak të shkeljes së Ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo ndaj të dënuarit akuza të refuzohet.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr.12/2016 datë 27.1.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e mbrojtësit të të dënuarit R. B. të refuzohet.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka theksuar se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet e ligjit penal për faktin se i dënuari trajtohet si person zyrtar dhe është gjykuar për veprë penale që mund ta kryejë vetëm personi

zyrtar, duke konsideruar se i dënuari është me profesion roje pylli, e meqë nuk është person i zgjedhur apo i emëruar dhe pasi që nuk ushtron detyra të posaçme zyrtare të caktuara me ligj, në bazë të autorizimit, konsideron se nuk mund të jetë kryes i kësaj vepre penale.

Po ashtu konsideron se meqë i dënuari nga Gjykata e Apelit është shpallur fajtor për veprën penale nga par. 2 i nenit 343 të KPK-së për të cilin është paraparë dënimi prej 3 muajsh gjer në 3(tri) vite, ndërsa vepra penale është kryer në mesin e vitit 2009, Gjykata e Apelit vendimin e formës së prerë e ka marrë me 17 nëntor 2015, ka kaluar koha më tepër se gjashtë vite duke konsideruar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konform dispozitave të nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së, dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nga shkresat e çështjes rrjedh se i dënuari R. B. është punëtor i Autoritetit Pyjor të Kosovës (AKP) në detyrën e pylltarit, në zonën e Kuvendit Komunal në Istog, i cili me të dëmtuarin R. S., nga ..., është marrë vesh që i njëjti të pres dru në zonën "...", ku i dënuari ka qenë roje pylli, njashtu që për drutë e prera të paguaj shumën e caktuar të të hollave siç ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, bile sipas marrëveshjes me të dënuarin kur ndonjëherë t'i ngrit fletëparaqitje, dënimin me gjobë do t'ia paguajë i dënuari, vetëm e vetëm për ta arsyetuar dëmin e shkaktuar në pyll, të cilin i dënuari ka qenë i autorizuar ta ruaj.

Sipas të dëmtuarit, i cili vërteton rrethanat se sipas kërkesës së të dënuarit para muajit maj të vitit 2011, në vendin e quajtur "...", i ka prerë 6 trupa të bredhit, të cilat me kalë ia ka bartur 200-300 m duke ia qitur në vendin ku i dënuari mund t'i bartë me automjet.

Andaj, nisur nga këto rrethana të cilat nuk janë as kontestuese, se i dënuari ka qenë punëtori i Autoritetit Pyjor të Kosovës për zonën e Kuvendit Komunal në Istog(roje pylli), i dënuari ka qenë i autorizuar për ruajtjen e pyllit në zonat ku i dëmtuari i ka prerë drutë. Nga kjo vërtetohet se i dënuari ka qenë person i autorizuar në ushtrimin e detyrës së rojtarit të pyllit, i cili në mënyrë të kundërligjshme ka bërë shfrytëzimin e pozitës dhe autorizimeve zyrtare duke i mundësuar të dëmtuarin R. ta bëjë prerjen e druve me qëllim të përvetësimit të hollave andaj, të

pabazuara janë pretendimet nga kërkesa e mbrojtësit se këtë vepër penale mund ta kryejnë vetëm personat e zgjedhur apo të emëruar që ushtrojnë detyrat e posaçme zyrtare.

Po ashtu qëndron fakti se sipas dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i dënuari është shpallur fajtor për një vepër penale të vazhduar, e cila fillon nga 26.7.2009 ndërsa përfundon në muajin maj të vitit 2011, vepër kjo e ricilësuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë në par. 2 të nenit 343 të KPK-së për të cilën vepër penale është i paraparë dënimi prej 3 muajve deri në 3 vite, mirëpo janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për faktin se kur bëhet fjalë për vepër penale të vazhduar, i cili sipas dispozitave të Kodit Penal, i cili ka qenë në fuqi, ka qenë konstruksion i praktikës gjyqësore, në rastet e tilla parashkrimi i ndjekjes penale fillon të ecë nga momenti (dita) prej kur është ndërmarrë veprimi i fundit i kryerjes së veprës penale andaj, në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për parashkrimin absolut të ndjekjes penale.

Nga çka u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

PML.nr.15/2016 datë 15 shkurt 2016

Procesmbajtëse,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta